



**DALËSE - IZLAZNA - OUTGOING**  
REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA  
QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal  
Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije  
Ministry of Local Government Administration

Nr. Br. 020-305/4  
No. -VI-  
Data Datim 15.05.2023  
Dati

Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government  
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal  
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave  
Ministry of Local Government Administration

Për:	Xhafer Gashi, Kryetar i Komunës së Obiliqit Vlora Mjekiqi Kabashi, Kryesuese e Kuvendit të Komunës së Obiliqit	
Kopje:	Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në Komunë	
Përmes:	Elbert Krasniqi, Ministër i MAPL-së Trim Berisha Zv. Sekretar i Përgjithshëm i MAPL-së	
Nga:	Besim Myrtezani, Zv. Udhëheqës i Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave	<b>Data:</b> 12.04.2023 Nr.-VI-020-305
Zyrtarët përgjegjës:	Gëzim Sahiti, Zv. Udhëheqës i Divizionit për Monitorim të Komunave Ardita Latifi, Zyrtare e lartë për Monitorimin e Komunave	
Lënda:	Shqyrtim i ligjshmërisë së aktit të Kuvendit të Komunës	
Lloji i aktit:	Vendim Nr. -I-36 për shpalljen me interes të përgjithshëm publik për shpronësimin e Njësive Kadastrale	

I nderuar Kryetar,  
I nderuar Kryesues,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, si dhe Rregulloren nr. 06/2021 për ndryshimplotësimin e Rregullores (QRK) Nr. 10/2019, për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 02/2021 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

Vendim Nr. -I-36 për shpalljen me interes të përgjithshëm publik për shpronësimin e Njësive Kadastrale
I miratuar më datë: 28.03.2023
I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 31.03.2023

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës, është në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi. Ndërsa sa i përket përmbajtjes së aktit si dhe obligimeve ndaj palëve tjera janë në përgjegjësi të komunës.

### Arsyetim

Kuvendi i Komunës së Obiliqit në mbledhjen e mbajtur me datë 28.03.2023, ka miratuar Vendimin Nr. -I-36 për shpalljen me interes të përgjithshëm publik për shpronësimin e Njësive Kadastrale.

MAPL, konstaton së vendimi i nxjerrë nga Kuvendi i Komunës së Obiliqit, është bazuar në Ligjin Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale si dhe nenin 27 të Ligjit 06/L-092, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës si dhe nenin 34 të Rregullores (QRK) Nr.09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme të komunës.

Vendimi është miratuar në mbledhjen e Kuvendit të Komunës së Obiliqit me datë 28.03.2023, është miratuar me 15 vota "për", 0 "kundër" dhe 5 "abstenim".

*Komuna pas marrjes së vendimit për shpallje të interesit të përgjithshëm publik për pronat e menaxhuara nga Agjencia Kosovare e Privatizimit duhet të zhvillojë procedurat për bartjen e këtyre pronave. Të drejtën e bartjes të pronave të menaxhuara nga AKP-ja, komunat mund ta realizojnë përmes procesit të shpronësimit dhe Ligjit Nr.06/L-023 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.04/L-034 për agjencinë kosovare të privatizimit, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.04/L-115 dhe me Ligjin Nr.05/L-080.*

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm lidhur me këtë vlerësim.



## Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave

Ministry of Local Government Administration

Za:	Xhafer Gashi, gradonačelnik opštine Obilic Vlora Mjekiqi Kabashi, predsedavajući Skupštine opštine Obilic	
Cc:	Jedinici za administraciju dokumenata u MALS-u Jedinici za administraciju dokumenata u opštini	
Preko:	Elbert Krasniqi, ministar MALS-a, Trim Berisha, zamenik generalnog sekretara u MALS-u	
Od:	Besim Myrtezani, zamenik rukovodioca Pravnog odeljenja i monitorisanje opština MALS	Datum: 12.04.2023 Br.-VI-020-305
1.Službenik-ca za utvrđivanje pravne procene:	Gëzim Sahiti, V.d zamenik Odseka za monitorisanje opština	
2.Službenik-ca za izradu pravne procene:	Ardita Latifi, viša službenica za monitorisanje opština	
Predmet:	Potvrda zakonitosti odluke Skupštine opštine Obilica	
Vrsta akta:	Odluka	

Poštovani gradonačelnice,  
Poštovani predsedavajući,

U saglasnosti sa Uredbom Vlade Republike Kosova br. 10/2019 o administrativnom razmatranju opštinskih akata kao i Uredbom br. 06/2021 o izmeni i dopuni Uredbe (VRK) br. 10/2019 o administrativnom razmatranju opštinskih akata, na osnovu zakonskih ovlašćenja određenim osnovnim zakonima i Uredbom Vlade br. 02/2021 o oblastima odgovornosti administrativne Kancelarije premijera i ministarstava, pravno odeljenje i monitorisanje opština ministarstva administracije lokalne samouprave, primilo je za obavezno razmatranje zakonitosti, kako je predviđeno članom 81. Zakona br. 03/L-040 o lokalnoj samoupravi, sledeći opštinski akt:

Odluka br. -I-36 za proglašenje od opšteg javnog interesa

Usvojena dana, 28.03.2023.godine

Predložena na razmatranje u MALS-u dana 31.03.2023 godine

Ministarstvo administracije lokalne samouprave, nakon razmatranja sadržaja gore navedenog opštinskog akta, ceni da je opštinski akt u skladu sa odredbama zakonodavstva na snazi. Dok, što se tiče sadržaja akta, tako i obaveze prema drugim licima, su u nadležnostima opštine

### Obrazloženje

Skupština opštine Obilić, na sednici održanoj dana, 28.03.2023.godine, usvojila je Odluku br. -I-36 o objavi od opšteg interesa.

MALS, konstatuje da je usvojena Odluka od strane Skupština opštine Obilić, zasnovana na Zakonu br. 03/L-040 o lokalnoj samoupravi kao i članu 27 Zakona 06/L-092, o davanju na korišćenje i razmenu nepokretne opštinske imovine, i članu 34 Uredbe (KRK) br. 09/ 2020 o utvrđivanju postupaka davanja na korišćenje i razmene nepokretne opštinske imovine.

Odluka je usvojena na sednici Skupštine opštine Obilić dana, 28.03.2023.godine, sa 15 vota "za", 0 "protiv" dhe 5 "uzdržanje".

*Nakon donošenja odluke o objavi od opšteg javnog interesa o imovinama kojom upravlja Kosovska agencija za privatizaciju, opština treba da razvije procedure za prenos ove imovine. Pravo prenosa imovina kojom upravlja KAP, opštine mogu ostvariti kroz proces eksproprijacije i Zakona br. 06/L-023 o izmeni i dopuni Zakona br. 04/L-034 o Kosovskoj agenciji za privatizaciju, izmenom i dopunom Zakona br. 04/L-115 i Zakona br. 05/L-080.*

Ministarstvo administracije lokalne samouprave ostaje na raspolaganju opštini za bilo kakva dalja pojašnjenja u vezi sa ovom procenom.